

## 2013, një vit sfidash e projektsh

### VITIT 2012, CELEBROHEN ME MARTESË 190 TË RINJ, DIVORCOHEN 126 TË TJERË

Gjatë vitit 2012 në zyrat e Gjendjes Civile të rrethit të Pogradecit u celebruan në martesë 190 të rinj e të reja, ndërsa 126 të tjerë u drejtuan Gjykatës për zgjidhje martesore. Burime zyrtare nga ky institucion bënë me dije se në rrethin e Pogradecit, 190 persona janë celebruar për vitin 2012, nga mosha 20 - 25 vjeç, e lart. Data e nënshkrimit të këtij akti, ose e regjistrimit të tij në gjendjen civile, sikurse dihet, është martesë zyrtare, data martesore dhe jo data e dasmës. Këtë sqarim, punonjëset e gjendjes civile ua bëjnë çiftëve të reja, madje edhe duke i qerasur në një dhomë me dekor kuptimplotë për këtë ditë të shënuar që kanë krijuar në mjediset e zyrave. Po a ndodh që gjithçka të shkojë mbarë si në muajin e mjalitit e të porsamartuarit të trashëgohe

për jetë? Të dhënat nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Pogradecit tregojnë se 2012-ta ka patur edhe 126 padi për zgjidhje martesore. "Ende pa u qetësuar mirë veshët nga boritë e dasmës, thotë Shqipe Toska, avokate në Pogradec, buçasin celularët për zgjidhje martesore mes çiftëve të reja. Prej tyre, 97 raste kanë përfunduar me zgjidhje martesash, ndërsa mbeten për t'u shqyrtuar edhe 29 kërkesë-padi. Sipas të dhënave pranë kësaj gjykate, për rastet e gjykuara deri më sot, 44 prej padive janë ngritur nga burrat dhe 53 prej grave. Disa nga shkaqet e zgjidhjes së maresave, burimet veçojnë mungesën në familje për një kohë të gjatë të njërit prej bashkëshortëve, për shkak të emigracionit, alkoolin, bixhozin, tradhtinë bashkëshortore, dhunën në familje, por edhe pamundësinë e kushteve ekonomike në disa prej tyre.

### MOT I THATE E ME NGRICA, FSHATRA TE BLOKUAR NGA RRUGET ME AKULL




Moti i thatë i shoqëruar me ngrica e temperatura te ulta disa gradë nën zero në rajonin juglindor të vendit ka shkaktuar probleme për lëvizjen e qarkullimit normal me automjete në disa fshatra te Mokres në Pogradec, Oparit ne Korcë e Mirasit ne Devoll. Por, nuk është krijuar asnjë problem përse i pëket gjendjes se rezervave ushqimore dhe furnizimit me medikamente mjekësore.

Sipas Feim Jasharllari, kryetar i komunës Mokra e Sipërme, 15 fshatra te kesaj komune jane te bllokuara për shkak të akullit ne aksin rural qe lidh Trebinjën me Korcën e Pogradecin, per 100 m rrugë te vendi i quajtur "Varret e grekëve". Megjithë kontaktet me Drejtorine Kombëtare të Rrugëve, nuk po ndërhyhet për të normalizuar gjendjen.

Ndërsa ne komunën e Velcanit, Mokra e Poshtme, sipas kry-

Flet XHEVAT BALLIU, DREJTORI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE SLABINJË

### Me nxënësit e shkollës 9-vjeçare të Slabinjës



### AUTOGRAFET E 100 VJETORIT TË PAVARËSISË: TOMI MATO, BUJAR BALLIU, TASO, BESIM SHYTI

Mirënjohje nga Haki BALLIU

Nëpër vitet demokraci më kanë dhuruar shumë libra me autograf, jo sikur ata me një rëndësi të veçantë autografin dhe me tjetrën paratë. Janë shkëmbime "Firmash" mes autorësh të njohur nëpërmjet botimeve. Librat me autograf për mua kanë një ndjesi të dyfishtë: Përveçse mbush kohën e leximit, ndjej frymëmarrjen miqësore të dhuruesit. Në këtë shkrim po kujtoj katër nga miqtë e m'i që botuan në vjesh tën e 100 Vjetorit të Pavarësisë.

\*\*\*  
**TOMI MATO**, promovoi "Kutelin", më 23 nëntor 2012. Mes shumë miqve pogradecarë ishim të pranishëm edhe në mokraret e Shoqatës "Palioni". Pas prezantimit që i bëri librit "Piktori i Merituar" pogradecar Anastas Konstandini, thamë ndonjë fjalë zemre. Libri i Tom Matos, i redaktuar nga profesor Dhimitër Gegprifti, me artin grafik të Flori Slatinës, është një vepër e kompozuar mrekullisht në kushtim të Kutelit. Përveç materialit jetësor, falë kujtesës së autorit, libri është

të veshur me mjeshtëri artistike. Njëherë sjell shumë dëshmi gojore nga personalitetet e kulturës, aq dhe të nxjerra nga arkivat. Ashu siç bëri me librin "Të vërteta e të pathëna për Lasgushin", po kështu edhe ca më bukur se kaq, autori na befason me të vërtetat e panjohura për "Kalvarin e jetës plot brenga" e shkrimtarit të papërsëritshëm. Sigurisht s'janë vetëm brenat që lartësojnë figurën e Kutelit. Është lufta e qëndresa e tij përtej së pamundurës. Kuteli u përball me përndjekjen mizore të diktaturës dhe nuk u thye. Zëri i tij nuk u shua. Penën nuk e lëshoi. Madje me tregimin "Si u takua Ndoni me Zallorët", erdhi gjeri në fshatin tim. Le të kujtojmë se në fillimin e shekullit të kaluar, Pogradeci vetëm me 4 mijë banorë kishte disa personalitete të shquara si: Lasgushi, Kuteli, Dr. Jani Basho etj. Nëse bota turistike na pyet me dyshim se ku i kemi të mëdhenjtë e kulturës, tanimë dy kollozjtë e letërsisë do t'i gjejmë ne librat e Tomit, ashtu si të madhin Jani Basho në librin e Jovan Bashos.

(vijon ne faqen 3)

### Miti parmendës në treven e Mokrës

Nga Zabit CUKU

### NIKO NIKOLLA: "MOS E MERRNI JETËN SI TRAGJEDI, POR SI KOMEDI"

-Shtatë vjet nga ikja e njeriut të humorit-

### Kolina Buzo, solistja e ilazoreve

Nga Fahri MUÇO

### FYELLI I TANËS

Varianti mokrar i baladës aritore

Nga Kristaq NANUSHI





## MOT I THATE E ME NGRICA, FSHATRA TE BLOKUAR NGA RRUGET ME AKULL

Moti i thatë i shoqëruar me ngrica e temperaturë te ulta disa gradë nën zero në rajonin juglindor të vendit ka shkaktuar probleme për lëvizjen e qarkullimit normal me automjete në disa fshatra të Mokres në Pogradec, Oparit në Korçë e Mirasit në Devoll. Por, nuk është krijuar asnjë problem përpara i pëket gjendjes së rezervave ushqimore dhe furnizimit me medikamente mjekësore.

Sipas Feim Jasharllari, kryetar i komunës Mokra e Sipërme, 15 fshatra të kesaj komune janë të bllokuara për shkak të akullit në aksin rural që lidh Trebinjën me Korçën e Pogradecin, për 100 m rrugë të vendi i quajtur "Varret e grekëve". Megjithë kontaktet me Drejtorinë Kombëtare të Rrugëve, nuk po ndërhyhet për të normalizuar gjendjen.

Ndërsa në komunën e Velcanit, Mokra e Poshtme, sipas kryetarit të komunës, Ilija Mane, ka patur probleme për shkak të dimrit në rruget e fshatrave. Kjo komunë me rreth 4000 banorë është 62 km larg Pogradecit dhe për këtë arsye nga ana e vetë këshil-

lit të komunës është blerë dhe është në dispozicion për të mos pritur gjithçka nga ndërmarrja e mirëmbajtjes së rrugëve një fadromë dhe një traktor.

Probleme për qarkullimin për shkak të akullit kanë edhe rrugët rurale në fshatra të komunave Lekas, Vithkuq e Miras. Duke nxjerrë mësim nga përvoja e hidhur e vitit të kaluar, thotë sekretari i komunës Lekas, Gjergji Ruka, kur komuna jonë u bllokua nga dimri për më shumë se dy muaj, këtë vit ka një furnizim më të madh me rezerva ushqimore dhe jeta është në normalitet dhe nuk ka situata emergjente. Ndërsa kryetari i komunës Miras, Devoll, Kryeart Sejdo, pohon se vec masave nga ana e komunës për normalizimin e gjendjes nga situatat e papritura të dimrit, janë vetë banorët që nuk presin, por e marrin vetë gjendjen në dorë dhe u hapin rrugën fëmijëve për në shkollë nga dëborë, ndërsa përpara u përket rezervave ushqimore si, miell për bukë, perime të thata, pastërma e dru zjarri, i kanë siguruar në vjeshtë për një periudhë të gjatë kohe.



### NDAHET NGA JETA LLAMBI KOKONESHI

U nda nga jeta më 23 dhjetor në moshën 83 vjeçare, i përcjellë nga fëmijët, të afërmit dhe miqtë e tij të shumtë.

Lindi në vitin 1929 në fshatin Llëngë të rrethit Pogradec. Rrjedh nga një familje fshatare me tradita të larta atdhedashurie, nip dhe stërnip i Jasko dhe Tun Kokoneshit, luftëtarit me armë që i kushtoi gjithçka lirisë dhe pavarësisë së atdheut. Në vitin 1948 kreu shërbimin ushtarak në Gardën e Republikës, më pas u arsimua dhe mori titullim mësues për shkollën fillore, detyrë të cilën e kreu me nder, devotshmëri e përkushtim derisa mbushi moshën e pensionit. Janë të shumtë njerëzit e arsimuar të fshatit Llëngë që mësimet e para i morën nga mësuesi i paepur në vite, Llambi Kokoneshi.

Xha Llambi rriti dhe edukoi katër fëmijë, i arsimoi dhe sot punojnë me nder e përkushtim në sektorë të ndryshëm të jetës. Pas pensionimit punoi pa reshur si aktivist shoqëror për



edukimin e nipave dhe mbesave të tij me virtyte të mira.

U nda nga jeta më 23 dhjetor në moshën 83 vjeçare, i përcjellë nga fëmijët, të afërmit dhe miqtë e tij të shumtë.

LLazi Tona, Sami Leka, Izja Xhika, Fari Muço



## Pogradec - Ura bashkëveprimi kundër dhunës në familje

Nga Dhimitër Gegprifti

MUND TË VIHET E VEÇANTË BRENDA SHKRIMIT

Pas një Konference të suksesshme në tetor të këtij viti, shoqata "Unë Gruaja" në qytetin e Pogradecit, vazhdoi me një aktivitet tjetër, mbylljen e fushatës "16 Ditë Aktivizëm Kundër Dhunës ndaj Gruas (25 nëntor-10 Dhjetor). Ky aktivitet u bë në bashkëpunim me Bashkinë e qytetit dhe Mekanizmin e Referimit të Rasteve kundër Dhunës në Familje, me mbështetjen e shoqatës "Refleksione" dhe "Un-Trust Fund", përfaqësues institucionesh, pjesëmarrje qytetare, mediat lokale: TV "SOT7", gazeta "Nositi".

Afroviti Gusho, themeluese e shoqatës "Unë, Gruaja" në fjalën e saj përshëndetëse theksoi: "Sot më 10 Dhjetor po mbyllim fushatën 16 Ditë Aktivizëm, që sivjet u zhvillua nën moton: "Nga Paqja në shtëpi tek Paqja në Botë!". Sot do të shkojmë edhe më përpara në përpjekjet tona të për-bashkëta, për ta luftuar Dhunën atje, ku ndodh, me ndihmën e Ligjit dhe të gjithë institucionëve të angazhuara për ta bërë këtë gjë". Aktiviteti u finalizua me nënshkrimin e Marrëveshjes për fuqizimin e këtij Mekanizmi nga të gjithë aktorët, që e formojnë atë: nga Kryetari i Bashkisë e të gjithë me radhë, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.334, datë 17.02. 2011, duke treguar kështu se janë një model angazhimi dhe përkushtimi.

"Milionë gra dhe vajzave në mbarë botën janë sulmuar, rrahur, përdhunuar, gjymtuar apo vranë çfarë përbën shkelje të tmerrshme të të drejtave të tyre njerëzore....Ne duhet të sfidojmë rrënjësisht kulturën e diskriminimit që lejon të vazhdojë dhuna. Në këtë Ditë Ndërkombëtare, unë i bëj thirrje të gjitha qeverive që të mbajnë premtimet e tyre për t'i dhënë fund të gjitha formave të dhunës kundër grave dhe vajzave në të gjitha pjesët e botës, dhe i nxis të gjithë njerëzit ta mbështetin këtë objektiv të rëndësishëm."

Sekretari i Përgjithshëm Ban KI-MOON, mesazh në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave


### Opinion

Dhuna në familjen shqiptare, aktualisht, është dhe mbetet një problem i mprehtë social, i vështirë për ta eliminuar atë plotësisht nga jeta jonë e përditshme. Tendencia e zhvillimit dhe shfaqjes së kësaj Dhune herë nënton të minimizohet, por edhe shfaqet frikshëm. Ajo shfaqet në format e saj psikologjike dhe në formën e saj fizike deri në makabritet, raste, që në shkallë vendi nuk kanë munguar të jenë të pranishëm në jetën shqiptare. Kjo Dhunë shfaqet në raporte dhe me shkaqe të ndryshme: koncepte regresive si atavizma të së kaluarës, por edhe nga shkaqe sociale të reja negative, që erdhën si rezultat i hapjes së Shqipërisë me Botën: droga, alkooli, trafikimi, prostitucioni, etj. Por ajo, që është për t'u nënvizuar dhe që ka patur dhe vazhdon të ketë interes publik, është Dhuna, që ushtrohet ndaj grave dhe vajzave, pra ndaj femrës, duke e parë atë si një element të dobët, të pambrojtur, të detyruar t'i nënshtro-

het çdo lloji sjellje dhe Dhunë në familje dhe jashtë saj. Realiteti shqiptar ka treguar se ka edhe femra, të cilat kanë reaguar në forma të ndryshme, deri dhe me zhdurjen fizike të atyre, që kanë menduar se ua kishin bërë jetën të padurueshme dhe të padobishme. Kjo Dhunë shfaqet dhe rishfaqet edhe midis seksit mashkull nga shkaqet e njëjta, por edhe specifike të familjes shqiptare nga raportet e brendshme, traditat konservatore të saj. Është për t'u nënvizuar fakti tjetër se Shqiptari, Qeveria, Parlamenti, por edhe Shoqëria Civile, pothuajse në mënyrë të vazhdueshme është shqetësuar, duke nxitur gjithmonë opinionin pozitiv, tolerancën kulturore, aftësitë komunikuese brenda anëtarëve të familjes për të bërë gjithnjë e më shumë të mundur që kjo dukuri regresive, shqetësuese të shkojë çdo ditë e më shumë drejt minimizimit, me tendencë eliminimit e saj përfundimtar, duke forcuar dhe zbatuar ligjet.

### HEKUR-NIKELI

Në ditët e sotme e tendenca ka ndryshuar dhe nga kërkesat që janë vemendja kryesore është tek materialet e ndërtimit duke u quajtur si baza e të ardhurave. Nga specialistët dhe studimet e kryera një nga këto materiale është edhe Hekur-Nikeli. Me këto pasuri vendi ynë ka qënë dhe mbetet si një vend shumë i pasur në Rajon e më gjërë. Zonat e Librazhdit, Pogradecit Korçës dhe Përrenjasit, janë me shumë pasuri të këtij lloji minerali. Këto gjenden mbi tokë, por pjesa më e madhe dhe më cilësore gjendet në thellësitë e nentokës me sasira shumë të mëdha. Hekur-Nikeli është vendosur në listën e së ardhmes. Kjo për vetë nevojat e kërkesat që vijnë në rritje të vazhdueshme. Nga studimet dhe specialistet e kësaj fushe jepen te dhena se aktualisht gjenden mbi 220 milionë tonë hekur nikeli dhe mbi 105 milionë ton nikel silikat. Thesksohet se rezervat ka ë qënë mbi 300 milionë ton. Këto minerale janë me përbërje të së njëjtës familje xeherorësh dhe kanë një përdorim të gjërë në industrinë e rëndë si lënda e parë për hekurin dhe nikelin. Krijimi i mundësive për të shfrytëzuar këto mundësi jënë një rritje e mirqënies dhe e të ardhurave në zonat mineral mbajtëse. Z.C





FLET XHEVAT BALLIU, DREJTORI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE SLABINJË

# 83 nxënësit e shkollës së Slabinjës

*Drejtori i Shkollës 9 vjeçare Slabinjë më 24 gusht 2012, shprehet me nota optimiste për sistemin e arsimit në këtë fshat. Pas tre vjetësh drejtues kryesor i shkollës, shprehet për gazetën "Mokra"*

**\* Kur jeni njohur me gazetën "Mokra"**

Ishte muaji prill i vitit 1999, kur bleva në Pogradec, gazetën "Mokra", numrin e parë që kish-te dalë më 25 mars 1999. E ndjek, por kemi vështërsi për ta marrë, këtë e sigurojmë në Pogradec, jam lexues i rregullt. Stafii i kësaj gazete duhet përgëzuar për punën që bëjnë.

**Si ikini marrëdhëniet me librat?**

Në këto vende të bukura, shokët e pandarë të mi janë librat. Ato i kam lexuar vazhdimisht, edhe pse i kam siguruar me vështërsi. Kur shkoj në Pogradec, nuk rri pa blerë ndonjë libër, dhe nga do që shkoj librin e mbaj me vete. Bibloteka ime personale është rritur bashkë me mua, ajo nuk ka ngelë në këtë nivel arsimor e kualifikim. Unë lexoi jo vetëm në shkollë, por edhe në shtëpi.

**Arsimimi i Juaj nuk ka qënë i lehtë?**

Përkushtimi dhe vullneti bën gjithçka. Pasi mbarova klasën e 8-të, nuk mu dha e drejta e vazhdimi të shkollës së mesme. E fillova pa shkëputje nga puna, dhe e përfundova me ndihmën e një burri të respektuar, në atë kohë kryetar i kooperativës Slabinjë, zoti Ilija Llakmani fillova shkollën e lartë, Fakultetin Ekonomi-Agrare, në Institutin Bujqësor Kamëz, Tiranë, në vitin 1974 dhe u diplomova më 11 maj 1979. Këtë shkollë e mbarova pa shkëputje nga puna, kur isha si ekonomist në kooperativë, ngrihesha herët në mëngjes dhe shkoja e studjoja në zyrë nga ora 05-7oo, se atje i kisha kushtet për studim.

Arsimi e kualifikimi nuk ka fund, në vitin 2002-2007, vazhdova për shkencat humane, më-

**Nga historiku i shkollës, efektiv i nxënësve para vitit 1990-të ka qënë deri në 250 nxënës, kjo ulje vazhdoi në 157-të nxënës, në 133, e në 121 dhe në shtator të vitit 2012-të kemi 83 nxënës dhe 28 fëmijë në kopsht. Por prapë jam mirë, se emigrimi ka ndikuar në shkollat e Mokrës, dhe të Slabinjës.**



sues histori-gjeografi, në universitetin e Elbasanit. Vështërsi pata, isha familjar, e kisha larg, pa shkëputje nga puna, por përkushtimi çfarë nuk bëka.

**Si filloi profesioni i Juaj, si mësues, kur ju keni qënë ekonomist?**

Pas viteve 1990-të, ndryshoi sistemi i pronës, kaluam në pronën private, kooperativa bujqësore e Slabinjës u shpërbë. Nuk kishte punë, kërkova punë në arsim. Në fillim më aktivizuan si mësues i jashtëm disa vjet dhe në kohën kur ishtë Drejtor i Shkollës, zoti Riza Balliu. Në vitin 2009, me punë arrita të bëhem Drejtor i Shkollës 9 vjeçare Slabinjë, pas zonjës Marieta Sinani. Kam mësuar nga Drejtorat e Shkollës, Riza Balliu, Fuat Fero e Marieta Sinani.

**Si ka ndikuar emigrimi dhe migrimi në shkollën tuaj?**

Nga historiku i shkollës, efektiv i nxënësve para vitit 1990-të ka qënë deri në 250 nxënës, kjo

ulje vazhdoi në 157-të nxënës, në 133, e në 121 dhe në shtator të vitit 2012-të kemi 83 nxënës dhe 28 fëmijë në kopsht. Por prapë jam mirë, se emigrimi ka ndikuar në shkollat e Mokrës, dhe të Slabinjës.

**Si e keni filluar vitin mësimor 2012-2013-të?**

Masat i kemi marrë të plota, do të funksionojnë të 9-të klasat, me 83 nxënës, klasa e parë më 9 vetë, klasa e dytë 7, klasa e 3-të 6, klasa e 4-të 13, klasa e 5-të 9, klasa e 6-të 9, klasa e 7-të 9, klasa e 8-të 14 vetë. Mësuesit në fillore 3, të mesme 4, drejtori, mesuese në kopsht 1 gjithsejt 9 mësues.

**Si është arsimimi e kualifikimi i mësuesve?**

Këtë vit mësimor 2012-2013-të, do të japin mësim në klasën e parë Marieta Sinani (cilki i ulët), klasa e dytë Mirela Bufi (histori-gjeografi të lartë), klasa e tretë Klodi Berberi (histori-gjeografi e lartë) klasa e pestë Gjergji Todolli (Biokimi), klasa e gjashtë Denis



Guri (Matematikë), klasa e shtatë Hallbina Beqollari (gjuhëletërsi), klasa e tetë Belegina Topalli (Anglisht), dhe për kopshtin Deliko Balliu.

Me punën e mësuesve u arrit një kalushmëri e mirë dhe me një notë mesatare 7,4. Klasa e nëntë e përfundon, 14 nxënës, 10 djem e 4 vajza, dhe viti 2012-2013-të do të vazhdojë me 9 nxënës.

**Si është baza materiale në shkollë?**

Baza materiale në përgjithësi është e mirë, laborator i biokimisë, i historisë i kompjuterave. Në vitin 2009, u vunë përdorim 6 kompjutera, ku jep mësim mësuesja e anglishtes Belegina Topalli. Programi i kompjuterit fillon që në klasën e tretë deri në të nëntën, natyrisht programi fillestar. Libri "Slabinja Jonë", është future në programin mësimor, në klasën e gjashtë, të njohim vendlindjen. Disiplina formale në shkollë është e mirë, fëmijët janë siguruar me kushte të plota, të mos dalin jshtë

borrit të shkollës. Në shkollë kanë kushte të mira, por duhen edhe më të mira.

**Ç'është për ju, shkolla, arsimi çfarë do të na thoni?**

Shkolla është bota e jetës, ata me shkollë nga ata pa shkollë, ndryshojnë sit ë vdekurit me të gjallët. Lekët e xhepit prishen, ndësa ato të mendjes të ngelen. Njeriu në jetë edhe mund të humbë, por duke bërë një vepër të mirë, ai është i gjallë.

Dashura është më e madhe se urrejtja, mirëkuptimi më i madh se inati, paqja më fisnike se lufta. Çdo gjë e mirë e këtij populli ka ardhur me sakrifica të mëdha, madje edhe me drama të përgjakshme. Falë njerzëve të shquar dhe bijëve të këtij populli kemi mundur të ruajmë identitetin tonë. Të flasim pak e të mësojmë shumë, të mbajmë parasysh edhe kontekstin se ku dhe kur t'i themi fjalët.

Falemiderit edhe një herë gazetës "Mokra".

**Intervistoi: Zenun FERRO**

(vijon nga faqja 1)

**\*\*\*  
"HEREMITI" I  
BUJAR BALLIUT**

Autori në autografin shumë miqësor, shënon: "Xha Hakiut, ikonës së letërsisë dhe shpirtit të madh të krahinës sonë". Në përgjigjen flesh mund ti them: "I madh je vetë! - Zotni ke qënë, më zotni je bërë!"

Letërsia dinjitoze e Bujarit, si një ëndërr e ngjuar, shfaqet e plotë në mbylljen e 100 viteve pavarësi. "Heremit", nuk gjejmë si titull tregimi. Duhet lexuar libri për të kuptuar dublin. Disa herë personazhet e skalitur mjeshtërisht nga pena e autorit kanë fillim të bukur me fund disi dramatik. Diçka si në mit, në një bukuri shembullore. Sikur ushtarët spar-

tanë të origjinës pellazge, të cilët përpara betejës krihnin flokët e gjata. Ata kishin të tyren ndjesinë e së bukurës, sipas së cilës gjatë ndeshje gjer në vdekje, flokët e krehura të ruanin hijen e shpatës. Bujari ka filozofinë e vet: nëse rrëfimi ndriçon të bukurën pa prekur dhembjen, s'ka përse të shkruhet.

Mua më mungon pena e kritikut letrar, të nxjerr vlerat ideoaristike, sikur ka bërë shkrimtari ynë i shquar Istref Haxhillari. Mua vetëm më ngopet shpirti kur lexoj botimet e shkrimtarëve të dalë nga "Dheu i Mokrës".

Të dy emrat që përmenda kanë dhe një krijimtari të suksesshme si bashkautorë. "Hapësirat rrallohen prej dhimbjes". Lexuesi befasohet pa qënë nevoja të pyesë se kush është më i miri: Zëri i parë, apo i dytë? I dyti apo

i parë? Një duet i kënduar për merak veç duartrokitet.

Gjithashtu Bujari është studiues i zellshëm i vëmendshëm i figurave të mëdha të letërsisë botërore. Në librin "Nobel" na sjell 107 ese dhe jetëshkrime të 107 novelistëve të letërsisë. Është ndryshe të shkruash për të mbushur faqet, ndryshe të zgjedhësh e të dish të shkruash si Bujari.

**"PELIONI" I TASOS**

Në verën e vitit të sapokaluar pata fatin të vizitohet ekspozitën vetjake të "Piktorit të Merituar" Anastas Kostandini e hapur në Tiranë. Taso i vëmendshëm më kërkoi librin tim "Rënia e Pelionit". Ia dhurova me shumë kënaqësi. Më 23 nëntorin e 100 viteve pavarësi bashkë me stafin e gazetës, vizitua përsëri ek-



spozitën e tij në Pogradec kushtuar jubileut shekullor të titulluar "Valon". Sapo më pa, më ftoi të shikoja tablonë ku paraqitej imazhi i varrezave monumentale të Selcës me shkronjat "PELIONI". "Idenë e kam marrë nga libri yt", më tha. Në mirënjohje pozuam përpara pikturës.

**\*\*\*  
"KUSH JAM.....?!"** Dyfjalëshi në pikëpyetje, çuditëse dhe pika pika, është titulli i librit që më dhuroi shkrimtari gorari, Besim Shyti. Në dekadën e fundit Besimi më ka dhuruar shtatë libra me autografe. I jam dedikuar me ndonjë shkrim në gazetën "Gora", si dhe ai mua tek "Mokra". Për librin e fundit nuk kam ç'farë t'i them, sespe i ka thënë vetë. Pavarësisht kësaj "Kush jam.....?!" është mesazh, është nxitje për cilindo që ka vlera njerzore si Besim Shyti me individualitetin e tij. Ajo ç'ka vjenë si e rrallë në librin e autorit, është sinqeriteti në rrëfim, e vërteta biografike, lufta për jetën. Besim Shyti nuk fshihet ç'ka qënë dhe ç'është si vepimtar shoqëror deri në pleqërinë e thellë. Kjo e lartëson ca më shumë figurën e tij.



PROMOVOHET LIBRI I AUTORIT TOMI MATOZ "KUTELI, KALVARI I NJË JETE PLOT BRENGA"

# Mitrush Kuteli, me monografi të plotë

Nga Zenun FERRO

Në sallën e arteve, në shtëpinë e kulturës në Pogradec "Lasgush Poradeci" ditën e premte më 23 nëntor 2012, promovohet libri i autorit Tomi Mato "Kuteli, kalvari një jete plot brenga" Salla ishte mbushur plot, aty merrin pjesë edhe kryetari i bashkisë Pogradecit Artan Shkëmbi, artistë, gazetarë dhe një grup i shoqatës "Pelioni" Haki Balliu, Flori Slatina, Fari Muça, Pëllumb Zade, Zenun Fero e tjerë. Libri doli nga botimi në nëntor 2012, me autor Tomi Mato, redaktor Dhimitër Gegprifti, arti grafik Flori Slatina, shtëpia botuese "Edlara" Takimin e promovimit e hapë piktori Anastas Konstandini (Taso), i cili theksoi se Tomi Mato në moshën 85 vjeçare, ngriti lart e më lart dy poetët e Pogradecit, Lasgushin e Kutelin me libra të veçantë.

Autori Tomi Mato flet me pasion. E kam njohur direkt Kutelin, kur ishte sëmurë në spital i kam shkuar bashkë me Doktor Misto Markon. Ai ka vuajtur shumë, këto pasqyrohen edhe në këtë libër. Natyrisht diskutantët këtu do të plotesojnë më tej e më mirë. Autori ka në plan edhe libra të tjerë si "Pogradeci e Franca" "Teatri në Pogradec e tjerë"

Redaktori Dhimitër Gegprifti, me atë theshtësinë e tij thekson: Redaktimi ka qënë imi, por truri dhe mendja ka qënë i Tomi Matos. Unë vura shenjat e pikësimit,



it, ai ka vënë mendimet. Për Mitrushin nuk ka pasur hapësira për botim. Edhe studimi që unë bëra në vitin 1968 për Mitrushin, Instituti i gjuhësisë nuk e botoi pa dy emra. Ky libër është një vlerë e munguar, dhe këtë e ka sjellë autori. Aty jepen fakte, ngjarje, biseda të jashtëzakonshme. Libri është i natyrës tregimtare, një jetë e kaluar vlera të pa njohura. Tani të dy shkrimtarët Lasgushi e Kuteli jetojnë edhe me libra në Pogradec.

Piktori Skënder Lako në këtë promovim, theksoi se libri ka ngjarje e fakte të gjalla. Janë përshkruar realisht, ai u ka dhënë përgjigje pyetjeve të shumta. Kuteli ishte i veçantë dhe nga larg kur e shikoje. Por nuk vlerësohesj nga pushteti i asaj kohe. Në vitin 1987 patëm shumë vështësi në fes-

timin e 80 vjetorit të Kutelit Strukturat e pushtetit nuk edhën, edhe vetëm studiuesi Aurel Plasari nga Tirana.

Kuteli në çdo vend që studioi, la emër të shkëlqyer. Një grup studiuesish shqiptarë shkuan për studime në Rumani. Drejtori i Universitetit Ekonomik pyeti: Jeni nga Shqipëria! Po nga Pogradeci ka! Nga Pogradeci që ka lënë gjurmë dhe emër të mirë në librin e nderit në këtë universitet e ka Pasko Dhimitri, nga Pogradeci. Ai ka lënë mbresa në këtë universitet, të bëheni si ai. Ai ishte një yll.

Mësuesi i letërsisë, në një shkollë në Tiranë, Fari Muça flet se në shkollën ku ai punon janë të dy librat e autorit Tomi Mato, Lasgush e Kuteli. Edhe unë krenohem me këta dy shkrimtarë, edhe me librat e Tomi Matos. Fig-

ura e tyre ngrihet çdo ditë, atë nuk e ulin dot. Avokati librave është autori i vet, që e mbron me emra, vepra e tjera.

Studiuesi Zenun Fero, nga shoqata "Pelioni", në këtë promovim foli, se autori Tomi Mato, ka ngritur jo vetëm vlerat e tij, por të Mitrushit, të Pogradecit. Në këtë libër dalin vlerat e mëdha të familjes Pasko Dhimitri. Babai Pandi, për të mbajtur familjen shkon në emigracion në Rumani, lidhet me patriotin Gjok Shqiptari, sjell libra shqipe në Pogradec, hap librarinë në Pogradec, ku me këto Mitrushi hodhi hapat e para.

Mitrushi nuk qëndroi në Rumani, ku i propozuan por erdhi të kontribonte për atdheun e tij. Edhe pse e dënuan në vitin 1945, nuk e hodhi poshtë atdheun. Në vitin 1943, shtëpia e Mitrushit digjet nga zjarri që i vunë italianët, babai i tij Pandi, duke u djegur mbronte arkën me librat e djalit. Kjo është familja Pogradecare, çdo gjë e bën për fëmijët.

Kryeredaktori i gazetës "Mokra" Flori Slatina foli me një admirim të veçantë për autorin. Është punuar në shumë vite dhe bashkë kemi punuar. Libri është si ditar, por shumë i saktë dhe i qartë. Të bën për vetë, me mënyrën e tregimit që ka.

Kryetari i Nderit i shoqatës "Pelioni" Haki Balliu, thekson se autori me këto dy librat e tij, për Lasgushin e Kutelin e ngrajnë lart Pogradecin. Ai edhe pse nuk është nga Mokra, është miku i Mokrarrëve e i shoqatës "Pelioni".

Ai na ndihmon dhe ne e ndihmojmë. Edhe në gazetën "Mokra" ai ka shkruar shumë për Pogradecin dhe për Mokrën. Redaktori ka bërë punë të mëdha por edhe autori është një redaktor i mirë.

Kryeredaktoria e gazetës "NOSITI" Afërdita Gusho, e njeh autorin Tomi Mato. Në këtë promovim theksoi se ka punuar shumë dhe i'a arriti qëllimit me këtë libër. Është një përkushtim i saktë, më vlera të mëdha, ka një stil të veçantë, të qartë. Libri ka vlera të mëdha. Ai ka shkruar për gjithë Pogradecin.

Gazetari Skënder Bemolli, në diskutimin e tij që bëri, theksoi se libri i Tomit është rilindje e Pogradecit, e Mitrushit. Tomi, themeloi teatrin e Korçës, por nuk qëndroi atje, erdhi në Pogradec, që e ngrii më lart. Libri ka disa të veçanta edhe për gazetarët.

Kryetari Shoqatës "Pelioni" Pëllumb Zade foli me një vlerësim për Tomin se atë e gjejmë kudo, e gjejmë edhe në Mokër. Ai shkante me doktor Miston, në Mokër. Për librin ai ka patur edhe vështësi por kemi të bëjmë me një shkrimtar të madh. Unë kam njohur Lasgushin, e mësuesin Qani Çollaku. Autori ka bashkëpunuar me shumë njerëz dhe ka nxjerrë një libër të vlerësuar.

Promovimi i librit të autorit Tomi Mato "Kuteli, kalvari i një jete plot brenga", i'u arrit qëllimit dhe autori nxori në pah edhe një herë vlerat e këti libri. Urime autorit për libra të tjerë në të ardhmen.

Nga Kristaq NANUSHI

Binte fyelli i çobani dhe lulet kundërmonin. Binte fyelli dhe zogjtë zinin këngën. Binte ky fyell dhe Tanën e linte pa fjalë. Pastaj pa qetësi. Pastaj pa gjumë.

Gjashtë vrima kishte ai i shkretë dhe jonet e zërit se si i bënte! Mbi vrimën e fundit luante gishti i vogël dhe dilnin ca trile të çuditshme! Ato edhe këndonin, edhe flisnin. Kush e dëgjonte, çuditej si binte ky fyell aq ndryshe nga të tjerët. Vetëm Tana, që e dëgjonte me dëshirë, e kuptonte ç'thoshte ai fyell me ato melodi.

Një ditë ajo pati një kokëshkrepje dhe mori malet. Për te fyelli. E gjeti në një limer. Dhe u shtang. I binte çobani i shtëpisë së saj, që rronte me delet në stan. Tek i binte, fytyra i qeshte. Nën qelshen e bardhë i dilnin të spërdredhura kaçurrela të zeza.

Bëri t'i afrohej, po jo, pati turp. Ndenji fshehur.

Ishte mëngjesi i ngopur me dritë, i kundërmuar me lule, i ndezur me këngë zogjsh. Fyelli nëpër to. Tana dëgjoi e dëgjoi dhe iku në shtëpi.

Tingujt i mbetën në vesh. Çobani në sy. Mëngjesin tjetër fyelli përsëri ra, me lodrën e gishtit të vogël. Tana s'vonoi dhe vrapoi drejt limerit. Ashtu, fshehur, ndenji ca më gjatë.

Tingujt i mbetën në vesh dhe në zemër. Çobani, në sy e në mendje. Tërë ditën pati përvëlím. Natën prushërim. Mezi priti të vinte mëngjesi.

Mëngjesi erdhi e Tana s'priti të dëgjonte fyellin. Vrapoi te limeri. Çobani s'ishte aty. Ajo u shtri mbi barin që kishte çelur luledede dhe po ëndërronte...

Çobani, si çdo mëngjes, erdhi. U afrua, por mbeti i shtangur dhe po sodiste i mekur. Ishte mëngjesi i freskët. Dëgjohej përshpërima e gjetheve, blegërma e deleve dhe këmbora e dashit përçor. "Ç" të jetë kjo? Mos është E Bukura e Pyllit, që ka dalë

## FYELLI I TANËS

Varianti mokrar i baladës baritore.\*

nga përrallat? Apo është xhind? Kaq e bukur, kjo do të jetë xhind! Ah, të ishte njeri!" nëpërmendi çobani dhe ofshani nga thellëshpirti.

Ofshamën Tana e dëgjoi dhe brofi më këmbë. Të dy u panë sy më sy. U afruan të ngrirë. Kapën duart dhe u shkrinë. Sytë e çobanit u mbushën me vajzë. Sytë e vajzës u mbushën me qiell.

Çobani e shtriu ngadalë mbi luledede. Pastaj e puthi ëmbël. Pastaj e mbuloi me trup. Tana u dridhërua. Pastaj u lëshua. Pastaj u fërgëllua. Pastaj u flakërua. Pastaj... nga një djegësirë e ëmbël u ngrit në qiell. U kap atje nëpër rreze dielli dhe varej e lëkundej mbi pyjet e lëndinat e vendit, nëpër të cilat kishte vrapuar që e vogël. Iu duk sikur i shihet për herë të fundit. E rrezëliti në qiell, ajo dihet fort. Sa fort! Fyelli i bënte melodi.

Nuk diti sa ndenji varur në qiell, po, kur u përmend, veten e pa të shtrirë në lëndinë. Një borzilok i egër, i çelur aty pranë, erëmonte fort. Në fund të këmbëve, më gjunjë, rrinte çobani fytyrëqeshur, me gjoksin zbërthyer. Të dy me sy të ujmuar, dihasnin me amëz borziloku.

Vajza u ngrit me turp dhe mori vrapin për në shtëpi. Këtë herë me çobanin brenda. "Të preeees!", - i thirri ai. "Jooooo!", - tha me vete ajo.

Po çne, mëngjesin tjetër Tana vrapoi më shpejt për te limeri, pa e pritur fyellin, me lodrën e gishtit të vogël. Kështu edhe mëngjesin tjetër, edhe mëngjesin tjetër...

Por një ditë... Një ditë fyelli ra ndryshe. Jo i gëzuar. As përkëdhelës. Ai dërgoi kumt:

Tanë, moj Tanë,

Lajmëro babanë,  
Dyzet hajdutë në stan.  
Qen'e zi na e vranë,  
Mua lidhur më kanë,  
Dyzet rurza i ndanë,  
Dashn' e zi po hanë!

Tana mbajti frymën tek i ati. Ky shpejt mblodhi fshatin dhe vrapuan në stan. Që në krismat e para hajdutët lanë gostinë dhe morën arratinë.

Babai u qetësua. Pastaj pyeti çobanin: -Si munde ta lajmërosh Tanën kaq shpejt e kaq larg?

-Ja, me këtë fyell unë edhe këndoj, edhe flas. Ky gishti i vogël flet me një gjuhë që Tana e kupton.

-Ah, e mora vesh! Prandaj ajo merr arratinë çdo mëngjes? Eëëëë, pa dale ta shoh pak atë gisht, vëre dorën këtu! - dhe i tregoi një trunç.

-Çobani vuri aty dorën. "Drëng!" bëri biçaku mbi të. Gishti i vogël u këput.

-Që të mos flasësh më me çupën time! Herën tjetër të këput kokën!

-Nuk binte më fyelli për Tanën. Priste e priste kjo. Prisinin edhe delet, edhe zogjtë, edhe lulet. Fyelli nuk binte.

Tana nuk duroi dot dhe shkoi në pyll, te limeri, te çobani.

-Pse nuk i bie më fyellit për mua?

S'kam se si t'i bie,  
O moj Tanë e ngratë,  
Se gishtin e vogël  
Ma ka prer' yt atë!

Tana u drodh. Kërkoj me sy gishtin e vogël dhe...

U lëshua si e marrë për në shtëpi, te babai. Se ç'thanë e ç'bënë atje, nuk e dimë. Pastaj u kthye po me vrap në pyll, te



Taso - "FYELLI I TANËS"

çobani. U hodhën në krahë të njëri - tjetrit. Dihatën përsëri fort në amëz të borzilokut të egër. Dhe ikën, kuturisën. Së pari, në ca kroje me ujë bore. Më tej s'dihet...

Në Mokër mbeti historia e fyellit që binte për Tanën.

Bie edhe sot fyelli i Tanës. Ka shekuj që s'pushon.

\*Sipas Prof. Q. Haxhihasanit, kjo baladë ka 61 variante, të mbledhura në krahina të ndryshme prej Institutit të Kulturës Popullore. Nga Pogradeci janë tri variante të regjistruara më 1928 në Hudenisht, më 1950 në Dunicë, më 1978 në Potkozhan. (Shih: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, "Çështje të folklorit shqiptar" IV, Tiranë 1989. fq.3).

\*Ky variant është i viteve të fundit, në Mokër e Poshtme, dhe u gjet me ndihmën e z. Haki Balliu, studjues dhe shkrimtar, intelektual i urtë dhe patriot, përfaqësues i denjë i vlerave të popullit të Mokrës. E falënderoj!



# Miti parmendës në treven e Mokrës

- \* Parmenda, cfurku, strumbullari i lëmit dhe djepi objekte pune, jetese po dhe mbrotje e familjes.
- \* Dragoi sulmon me parmendë, cfurk, strumbullar.
- \* Kuçedra mbrohet me djep (gjarpër me dy koka)

Nga Zabit CUKU

**P**armenda një vegël pune e bujku, fsha tarit nuk ka qënë vetëm një vegël pune por edhe një vegël e vjetër apo një objekt pagan i rëndësishëm kulti pagan shumë i rëndësishëm. Me këtë lidheshin shumë rite dhe besime të kohës dhe të arritjeve në të ardhurat e arritura gjatë një periudhe të caktuar kohe dimërore apo verore.

Mbi këtë objekt një ditë të caktuar duheshin të kryheshin disa rite të caktuara, me këto medohesh se arriheshin disa të ardhura dhe mbarësi dhe një bollëk më i mirë në të ardhurat e prodhimit bujësor, gëzime e lumturi në familje po edhe atë shoqërore. Parmenda ishte një vegël e cila nga fshatari ishte e përzgjedhur dhe për këtë duhesh të kishte disa të dhëna të cilat ishin të detyrueshme që të zbatoheshin se vetëm kështu do të sillte te ardhura dhe prodhime të gjëra në vitin pas ardhës, në të kundërt ajo do të humbiste vlerat e saj dhe nuk do kishte vlerat e cilësive të saj si një objekt kulti e pagan.

Parmeda si një objekt i rëndësishëm i fshatit pas mbarimit të punëve duhet të pastrohesh, riparohesh dhe të vendosesh në një vend të rëndësishëm në ndërtesën e shtëpisë si në bal-



lokne, në hajate, në nënstreha të katoteve, në hangare apo vende të jo të dukshme dhe të mbrojtuar nga lagësirat dhe drita e dilleit duke e lidhur, e varur dhe mos e mbajtur në tokë. Si rregull nuk duhet të futesh brenda në shtëpi, por në një vend të parë e aftë për vëprime të tjera të nëvojshme për familjen por edhe ne raste për mbrojtjen e saj.

Sipas besimeve të vjetra fetare kjo nuk ishte vetëm një objekt pune por edhe një objekt luftime e mbrojtje të familjes shtëpiake. Për këtë duhet të ishte e fortë e gatshme në çdo kohë dhe e përdorshme nga cilido pjesëtar i familjes si burra, djem, goca dhe gra deri të moshuara.

Sipas besimeve fetare të vjetra të rrënjësura në shekuj dragoi dhe kuçedra ishin në luftë të vazhdueshme me njëri tjetrin nga lindja e botës, por edhe në ditët e sotme. Kur ka bubullima të

fuqishme të kohës thuhet se këto shkatohen nga përplasjet e armëve të dragoit dhe të kuçedrës, (nga anët tona thuhet të gjarpërit më dy koka).

Dragoi sulmon kuçedrën me parmendë dhe cfurk apo strumbullar lëmi, kurse kuçedra mbrohet nga goditjet me anë të djepit, (djepi dhe gjarpëri me dy koka janë gjithmonë në tokë).

Përdorimi i këtyre objekteve, duhte të plotësonte dy kushte: Së pari parmenda, cfurku, strumbullari i lëmit dhe djepi nuk duhet të mallokeheshin kurrë nga ai që i përdorte dhe mbante. Së dyti në çdo kohë pas pune te pas-trohen, riparohen e te vendosen në vende të caktuara, si strehe e vende pa lagështirë, në mënyrë për tu marrë sa më shpejt për punë e për mbrojtje nga kuçedra. Edhe djepi kur kishte fëmijë të vegjël vendosesh mbi trarët e shtëpisë, mbi dhomën e zjarrit

në një vend të sigurtë të patstër dhe për tu marrë sa më shpejt.

Parmenda kur mbaronte puna në ugarin e tokës e nxirrte në cepin e arës me qëllim për tu marrë sa më shpejt nga dragoi kur kishte filluar rrebeshi i shiut se e dëmtonte atë duke mbetur në baltën e ugarit .

Sipas besimeve pagane lidhur me parmendën thesohet se puna për prodhimin e saj fillonte nga prodhimi i saj, pra nga prerja lëndës drurësore për parmendë e cila duhet të plotësonte shumë kushte dhe këto sa më cilësore. Prerja e drurit duhet në kohën e vjeshtës së dytë, druri të jetë me rrjedhje lëngu, jo çdo lloj druri bëhet parmendë, koha dhe fazat e hënës janë një element tjetër, se në lindje apo në perendim të saj. Prerja duhet me hënë të re pasi kishte kaluar dita e martë dhe e mërkurë. Dita duhet të ishte e kthjellët, koha të jetë pa ngrakesa, pa re, pa mjegull, një kohë e bukur se kështu parmenda do të ishte e fortë, dhe do të sjellë bereqet, bollëk në atë kohë pune.

Edhe në ditët se kur fillonte puna me parmendë kishte mjaft rëndësi dhe me paragjykime nga populli. Si një ditë e mbarë dhe me bollëk ishte fillimi i punës me parmendë dita e hënës, e enjte dhe e shtunë kurse ditët e martë, e mërkurë dhe e premte ishin të kufizuara dhe të pa përshtatshme, pasi kanë në përbërjen e tyre bashkëtingëlloren(r), në trupin e fjalës.

Mbi parmendë duke parë rëndësinë e saj si një vegël shumë e rëndësishme janë bërë edhe flijime. Flijimi si dukuri është i

njohur që në antikitet. Flijimi ka qënë dy llojesh: të përgjakura dhe jo të përgjakura. Këto në treven tonë njihen të dy llojet e flijimeve. Ky lloji flijimi i bëhet hyjnisë së tokës për ta marrë me të mirë, në mënyrë që ajo të japë sa më shumë prodhime të mbara dhe të bollshme. Në flijimin e gjakosur është therja një kafshe si gjel ose tjetër por të jetë mashkull mbi shtizën e parmendës dhe koka groposej në arë. Në flijimin jo të përgjakur e ze thyerja e një kulaçi mbi brirët e qeve ose te shtizës së parmendës. Kulaçi të jetë përgatitur mirë nga gruri i arës që po punon me parmendë. Ka raste që groposej një kokërr vezë ose një grusht me arra. Ka qënë zakon që në kurbanin e Sulltan-Novruzit të themin mbi shtizën e parmendës dhe të spërkasin me gjak plohrin dhe zgjedhën. Rastet e flijimit me gjak bëhen zakonisht kur fillonin mbjelljet e të lashtave. Kjo ka lidhje me faktin se mbjellja e grurit dhe e të lashtave shënon fillimin e vitit bujqësor se “me mbjelljen e tyre nis puna për mot-mot”.

Pjesë kryesore e parmendës është përdheci, pjesa e poshte e cila hyn në tokë e në majë ka plohrin; ka veshët që vijnë anash pas plohrin që shërbejnë për hapjen e dheut anash; doraku; shtiza një dru i gjatë që bashkon trupin me zgjedhen. Këto pjesë nuk shahen, nuk digjen dhe nuk mallkohen.

Plohri është një pjesë e pa ndarë e shumë e rëndësishme e parmendës, ky është një objekt që mbahet më i shtrenjti. Ky nuk kudo por pas punës pastrohesh dhe vendoset në vende të veçanta, të thata e të sigurt.

## KUR KA NISUR TË FESTOHET VITI I RI NË 1 JANAR ?

Nga Zabit CUKU

Romakët në fillim vitin e ri e festonin në mars, por kalendari i tyre ishte i sinkronizuar me diellin. Kështu Jul Cezari në vitin 46 para Krishtit, krijoi që edhe sot në ditët e sotme është i njohur si kalendari Julian, që stabilizonte fillimin e vitit të ri ditën e parë të vitit, pra në 1 janar. Këtë ditë romakët ftonin miqtë e tyre dhe shkëmbenin dhuratat nga një vazo të bardhë me mjaltë, dhe gjëra të tjera që ishin për urim për fat dhe lumturi. Sot shumë vende evropiane, përdorin kalendarin Julian, por deri në vitin 1751 në Angli dhe Uells (dhe të gjitha zonat britanike) viti i ri fillonte më 25 mars. Sipas traditës katolike, 1 janar është dita e rrethprerjes së Jezusit (në ditën e tetë nga lindja e tij), atëhere kur ju vu edhe emri. Ka vende si Tajlanda që e kanë sinkronizuar këtë festë shumë vonë, rreth vitit 1941. Ka edhe vende të tjera, si Republika Çeke, Italia, dhe Britania e Madhe, të cilat 1 Janari është shpallur festa kombëtare.



Për libërin e autorit Bujar BALLIU, “HEREMIT”

## TREGIMET FLASIN VETË

Nga Zenun FERO

**F**jalën fituesi për Çmimin NOBËL për letërsi MOJAN, përpara antarëve të Akademisë Suedeze e mbylli: “Unë jam tregimtar. Duke i rrëfyer tregimet fitova Çmimin Nobël për Letërsi. Shumë gjëra interesante kanë ndodhur me mua menjëherë mbas fitimit të çmimit, dhe ato më kanë bindur se e vërteta dhe drejtësia janë gjallë dhe mirë. Kështu unë do të vazhdoj t’i them tregimet e mia në ditët që vijjnë”. (Gazeta ‘Nacional’ 23 dhjetor 2012, Tiranë).

Kjo mu kujtua kur po lexoja librin ‘Heremit’ tregime, Tiranë, 2012 të autorit Bujar Balliu. Autorin e njoh direkt, është bashkëmohatar me mua, ia di nivelet intelektuale në çdo fushë, por në veçanti në letërsi.

Me librin e parë ‘Nobël’ laureantët e letërsisë deri në 2010, bëri një punë të veçantë voluminoze, dhe e kishte përgatitur shumë mirë. Shumë kritikë letërore e kanë vlersuar si libër të kohës, ndërsa mësuesit dhe nxën-

sit e kanë në bibliotekat e tyre.

Në librin ‘Hapsirat rrallohen prej dhimbjes’ autori Bujar Balliu, solli tregimet popullore shumë të bukura. Në Trebinjë, një fis mori emrin e Dragoit, Uji i ftohtë në krye te Slabinjës, ‘Kërkova kalë t, i hipja, jo të më hipte, e tjerë, janë treguar në mënyrën origjinale, në kushtet konkrete të Mokrës.

Libri ‘HEREMIT’ tregime, i autorit Bujar Balliu, ka në brendësi njëzet tregime të veçanta, origjinale, dhe aktuale. Nga njëzet tregime, rreth dhjetë tregime janë botuar në organet e përditëshme. Në revistën ‘Obelisk’ janë botuar tre tregime, në gazetën Durrak një, në gazetën ‘55’ një, në gazetën ‘Mokra’ një, dhe në gazetën ‘Nacional’ katër tregime.

Tregimi ‘Qyteti brenda tij’ prill 2011, i botuar në revistën ‘Obelisk’ për vitin 2011, është vlersuar si tregimi më i mirë i vitit, nga revista ‘Obelisk’... ‘Niko Nikolla zbriti nga makina me targa të Tiranës, me levë në dorë, Ku je more djalë? Pse nuk shkruan? E nise me shumë vrull. Pasione fluturake të rinisë... faqe 109. Kjo është e vërteta, Bujari u tërhoq disa vite nga krijimtaria, por kjo veretjetje i bëri efekt,



dhe filloj krijimtarinë.

Për këtë libër, Bujar Balliu punën e ka filluar me tregimin ‘Loti’ në korrik 2008 dhe e ka përfunduar me tregimin ‘Në pikën e nisjes, në korrik 2012, një punë e madhe katërvjeçare.

Për autorin, mënyra më e mirë është të flasi shkrimi. Fjalët e folura i merr era, ndërsa fjalët e shkruara kurrë nuk do të jenë zhdukur. Duhet durim për t’i lexuar librat e reja. Autorët nuk na detyrojnë ta bëjmë këtë, edhe nëse i lexojmë, nuk presin që mendimi ynë të ndryshojë. Ende nuk ka lindur shkrimtar në botë, që është nga të gjithë lexuesit e tij.

Tregimet e Bujar Balliut, nuk janë shkruar me anë të dëgjuarit. Kjo është traditë dhe



disa autorë e përsosin. Por këto tregime janë të veçanta, krijuese, si ‘Loti’, ‘Pëllëmbët’, ‘Jeta në dy net’, ‘Koleksion shpendësh në prill’, ‘Peng në gji të hënës’ etjeter.

Nismëtarëve të poezisë moderne në letërsinë shqipe, Mitrush Kuteli, që sot e kemi të bronxtë në ‘Sheshin e Monumenteve’ buzë liqenit të Ohrit, me një status të ri ‘Nderi i Kombit’ po i shtohen rradhët edhe nga Pogradeci me Bujar Balliu, Istref Haxhillarin, Haki Balliun Kristaq Manushin, Tomi Mato, Dhimitër Pojan-anku e shumë të tjerë.

Me këtë rast i uroj suksese autorit Bujar Balliut, presim gjini letrare të tjera. Ao do të flasin vetë.



PROFIL

## Një jetë me punë, nder e respekt!

-Isuf Bego, njeri i thjeshtë, i respektuar nga të gjithë-

Nga Dhimitër Gegprifti

Një detyrim për "Slabinjën tonë"

Slabibnja, fshat në Mokrën e Poshtme, në meorien e viteve, ka mbetur ashtu e tillë me historinë e njerëzve të saj. Njerëz të thjeshtë, të punës e të shakasë. Njerëz të respektueshëm, të dijës dhe kur është dashur edhe të sakrificës.

Slabinja dhe slabinjërit kanë pjesën e tyre në historinë e Mokrës, por edhe në atë Kombëtare: me Lashtësinë, në kohët e reja, por edhe në të sotnen.


Me gjithë lëvizjet e shumta në këto dy dekada Demokracie, ajo vazhdon të jetojë me njerëzit e saj në ato troje, në "Dheun e të parëve", por tani krejt ndryshe, me nivele e ide të reja, më të avancuara. Si e gjithë Mokra, edhe Slabinja, ndër të tjera, respekton dhe nderon mikun, shokun, mbi të gjitha, Njeriun me virtyte të larta për jetën dhe punën. E tillë është edhe në memorien tonë Slabinja dhe banorët e saj, megjithëse kanë kaluar 43 vite...E tillë do të mbetet...

Bego, një nga fiset e nderuara të këtij fshati. Slabinja është një fshat jo i vogël nga pikëpamja gjeo-grafike, nga banorët e saj, por edhe nga fiset: Balliu, Fero, Sinani, Çela, Kullolli, Kalija, Gorrica, Rroko e të tjerë.

Po cili është Isuf Gani Bego?

Isufi u lind në Slabinjë më 17 korrik të vitit 1943 në një familje të zakonshme fshatare, afërsisht e mesme nga ana ekonomike. Është një nga të shtatë fëmijët e xha Ganiut: Bukuria, Sabria, Resmie, Ramadan, Xhevdet, Lirie. Moshën e fëmijërisë, deri sa shkon për të kryer shërbimin ushtarak, në moshën 18-vjeçare, e kalon në fshatin e lindjes. Aty mbaron shkollën filllore dhe atë 7-vjeçare pa shpëputje nga puna. Në shkollë është dalluar për interes për arsim. Shërbimin ushtarak e kryen në qytetin e Tepeleneës në repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme në vitet 62-64.. Pasi punon disa vite pranë familjes në punë të ndryshme, shkon në Ndërmarrjen e Sharrave Bishnicë, e mandej po në të njëjtën punë, por tani në qytetin e Përrenjasit.

Viti 2005 e deri tani Isufi është në pension dhe si shumë mokrarë të tjerë, por edhe bashkëfshatarë, motra, vëllezër, nipër e mbesa jetojnë në qytetin e Pogradecit dhe në qytete të tjera të Shqipërisë, por edhe jashtë shtetit, deri në Amerikën e largët.. Ai është kënaqur dhe gëzon me fëmijët e tij: Durimin, Ad-



mirin dhe Bardhylin, me nipat dhe mbest: Adnand, Redina, Era, Eris, Anisa, Markel. Por edhe zonja e tij Nafia, që është nga fisi i Elezve të Velçanit ndihet jo më pak e kënaqur se Isufi.

Kur e pyetëm Isufin për nipërit dhe mbarsat, por edhe stërnipër, ai duke qeshur na u përgjigj: -Jo pak, por rreth 50. Dhe kjo është e natyrshme..

Të gjithë, pothuajse, kanë ecur në traditën e familjes: të punës, të dijës, të respektit, të nderit.

Isufi, aktivist shoqëror

Nëse do të dishë më shumë për jetën e tij, ai të përgjigjet se gjithmonë kam pasur në mendje të ndihmoj njerëzit, që kanë nevojë me të gjitha mundësitë e mia. Këtë e ka treguar në fshat, në punë, në kohën e lirë. Ai ka marrë pjesë në aksione kombëtare, por edhe në ekonomi për të cilat është dekoruar me medalje të punës nga Presidiumi i Kuvendit Popullor. Me motivacionin "Për realizimin e deturave dhe disiplinë shembullore në punë", viti 1984 Ka kryer dhe detyra e funksione shoqërore në sistemin monist. Edhe sot, kur po shkon drejt të 70-ve, atë do ta shohish në lëvizje, të flet, bisedon, ulet për një kafe, por gjen kohë edhe të lexojë dhe të ndjek aktivitetet të ndryshme, të ndjek emisionet televizive, të shkojë për vizitë, të merret me nipër e mbesa e të tjera.

Megjithëse banon në qytet, ai nuk e harron vendlindjen, ai ndien dhe ka mall për të, pse jo edhe më ndonjë rast mundohet ta shprehë në vargje të thjeshta, si një krijues popullor. "Mall për ty, moj Slabinjë/ Se jam rritur që fëmi/ Mall për miq e vëllazëri/ Mall për të gjithë me radhë/ Për Ju, o bashkëfshatarë/ Slabinjë, nuk të harroj kurrë/ Sa këta male, sa këta gurë!" Ai shkon shpesh dhe çmallet me të gjithë...

Ky ishte personazhi i profilit tonë Isufi i xha Ganiut të Begollarëve nga Slabinja e Mokrës së Pogradecit. Njeriu i thjeshtë, njeriu i punës dhe i respektit, që punoi dhe punon me ndershmëri e devotshmëri.

## NIKO NIKOLLA: "MOS E MERRNI JETËN SI TRAGJEDI, POR SI KOMEDI"

-SHTATË VJET NGA IKJA E NJERIUT TË HUMORIT-

Publicisti, humoristi dhe shkrimtari i njohur Niko Nikolla ndërroi jetë mëngjesin e datës 4 janar 2006 në Tiranë. I njohur në Shqipëri si njeriu i cili arriti të drejtojë për 25 vjet revistën "Hosteni", si kryeredaktor i saj, revista e parë opozitare në vend, Niko Nikolla e lidhi jetën e tij me gazetarinë sa dhe me humorin përgjatë 45 viteve. Shkrimtari Teodor Keko e quante babain e gazetarisë shqiptare, titull të cilin ai me modestinë e tij nuk e pranoi asnjëherë. "Gazetarët duhet të jenë me zemër të madhe, me mendje të ftohtë dhe me duar të pastra", citonte gjithnjë Nikolla, i cili lindi më 20 maj 1931 në qytetin e Pogradecit.

Punoj për shumë vite si gazetar pranë gazetës "Zëri i Popullit" dhe më pas si kryeredaktor i Revistës "Hosteni", deri në vitin 1991 kur doli në pension. Me qindra e qindra janë fejttonet, artikujt dhe reportazhet që mbajnë firmën e Niko Nikollës, në të gjithë shtypin shqiptar.

Dikush e ka quajtur optimisti i përjetshëm dhe si i tillë pas viteve '90, Niko Nikolla botoi libra në fushën e publicistikës, humorit, por edhe prozës. Përmenden këtu "Shënime të një gazetari", "Pushtimi i Amerikës", "Një angleze në rrugën e Dibrës", "Furtuna e janarit", "Lamtumirë Vlorë", "Njeriu pa emër", "Zhyl Verni në katror", "Mjaltë dhe Gjak", "Kronika nga Fronti i Dytë", "Vdekja e varrmihësit", "Një lumë midis dy shenjtorëve", "Dallëndyshtet e dimrit", "Koloneli me një sy", ndër- sa ka në proces botimi "100 Novela e tregime nga Ballkani".

Gjithashtu ai botoi një kolanë prej shtatë titujsh mbi temën e Ballkanit, ku përmes humorit sa dhe dramës arriti të shpreh ç'është Ballkani, ç'janë ballkanasit dhe si do të ecë Ballkani. "Ta kthejmë Ball-



Nderim për të paharruarin Niko Nikolla!

Shkrimtari dhe humoristi i shquar Niko Nikolla ka qenë i pranishëm në faqet e gazetës "Mokra", që në numrin e parë të saj. Personalisht e kam takuar shpesh, edhe 14 vjet më parë te kafe "Evropa" kur i kërkova diçka për gazetën dhe ai më dha tregimin "Karakteret mokrarësh" dhe më foli me entuziazëm e admirim nismën për të botuar një gazetë me emrin "Mokra". Si gazetar ka pasur rastin disa herë të udhëtojë në Mokër e të njohë shumë mokrarë, një pjesë prej të cilëve i kishte edhe miq. Gazeta shpreh edhe një herë vlerësimin e lartë për këët personalitet të letrave dhe humorit. I paharruar qoftë emri, vepra dhe kujtimi i këtij njeriu me zemër të madhe!

F. SLATINA

kanin nga një fuçi baruti në një fuçi humorit" është një nga shprehjet e humoristit, i cili në vitin 1991 botoi në këtë lëmë dhe revistën Ballkan, ku shkruan penat më të njohura të gadishullit tonë.

Gjatë aktivitetit të tij letrar-publicistik, Niko Nikolla është nderuar disa herë me çmime në konkurse të ndryshme letrare si dhe me pesë çmime të para në fushën e gazetarisë dhe të letërsisë si çmimi "Çajupi" në vitin 1989.

Miqtë e Niko Nikollës janë shprehur se humorit i tij buron nga tërë qenia e tij dhe ishte pjesë e së përditshmes së tij. Në ceremoninë e 70 vjetorit të tij, më 2001, Nikolla u tha miqve: "Nesër jam 71 vjeç, por nesër do t'u ndërroj vendin numrave dhe do të jem 17 vjeç".

Mes vlerësimeve që ka marrë veprimtaria e gjerë

publicistike dhe letrare e Niko Nikollës është dhe Urdhëri "Naim Frashëri" i klasit të parë (1978). Në vitin 2003 për "kontributin në fushën letraro-artistike, kontributin si gazetar, por edhe si veprimtar për qytetin e tij të lindjes", Këshilli Bashkiak i Pogradecit unanimisht i dha Niko Nikollës titullin "Qytetar nderi".

Niko Nikolla thoshte "gazetaria është një furrë e madhe që djeg çdo gjë dhe që në fund të mbetet vetëm pasioni..."

Pasioni për gazetarinë sa edhe për humorin e bëri atë që për gjatë dy javëve në gjendje të rëndë shëndetësore edhe pse nën kujdesin e mjekëve, askush të mos i jepte në kartelën e tij një diagnozë të saktë. Ndoshta ky është pasioni, por edhe humorit, apo thënia e famshme e tij "mos e merrni jetën si tragjedi, por si komedi".

## SAGA BALLKANIKE E LUAN STAROVËS NË 12 VËLLIME

Në fillim të shtatorit u paraqitën romanet "Kalaja nga hiri" dhe "Ervehe" si pjesë e projektit Vepra të zgjedhura të akademikut Luan Starova, në 12 vëllime, që e organizon Shoqata për art dhe kulturë të jetesës "Dialog", nga Shkupi. Në këtë më voluminoze nga produksioni i romaneve të një autori në Maqedoni, raporton MIA, prezantohet saga letrare ballkanike e shkrimtarit Luan Starova me rastin e 50 vjetorit të veprimtarisë së tij letrare dhe 70 vjetorit të tij. Me këtë projekt shënohet edhe 20 vjetori i fillimit të krijimit të sagës ballkanike me botimin e romanit "Librat e babait" në vitin 1992. Në skenën e letërsisë. Luan Starova u paraqit në fillim të viteve të gjashtëdhejtës të shekullit të kaluar dhe opusin e vet letrar e krijoi në gjuhën shqipe, maqedonase dhe franceze. "Krahas 'Librave të babait', në këtë zgjedhje bëjnë pjesë edhe romanet e njohura "Koha e dhive", "Çelsi ballkanik", "Muzeu ateist", "Rruga e ngjalave", "Klaja nga hiri", "Ervehe", "Dashuria e gjeneralit" dhe realizime të tjera të Luan Starovës të cilët me sukses të madh botohen në disa gjuhë në Evropë dhe në botë. Z. FERRO





# Dhimbja e çlirimit në plagët e gjalla të veteranit Maliq Rapçe

Nga Haki BALLIU

89

-vjeçari Maliq Rapçe vjen nëpër histori me shumë ngjare tronditëse, me kujtime të dhimbshme gatuar me rrjedhje gjaku.

Lufta I Botërore i la dy plagë, njëra përjetësisht e hapur, tjetra për 68 vite e fshehur.

Ky është personazh i rrallë që kam fatin t'ia sjell gazetës.

Maliq lindi në Velçanin e Mokrës, fshati i begatë, i burrave trima dhe i grave krenare. Velçani i 100 viteve pavarësi ka histori të pasur shembullore e frymëzuese. Velçani i dha luftës antifashiste 121 partizanë. Atdheut 11 dëshmorë, ndërkohe viktima të luftës u bënë mijëra krerë bagëti dhe 12 shtëpi të djegura.

Prej këtej, më sakte me Reshit Çollakun e nis rrëfimin Maliq Rapçe teksa pimë kafe në Laprakë. Ja çfarë kujtoi ai:

"Në fillim të vitit 1942 u organizua takimi në shtëpinë e Elmaz Menkshit, me roje te dera. Brenda zhvillohej kundër-shtimi mes mbështetësve të Reshit Collakut dhe atyre të Hasan Beut. Në fund u bë si punë votimi. Me Reshitin u rreshtuan vetëm dymbëdhjetë, ndërsa dhjetëfishi mbështeti Hasan Beun.

Reshiti duke ruajtur qetësinë i tha Hasan Beut: "Të gjithë këta që sot janë me ty nesër do të vijnë me mua". Ashtu doli vërtet, mbi 120 partizanë iu bashkuan Batalionit të Mokrës.

Maliq Rapçe ka historinë e jetës së tij, mbiemri Rapçe qysh së lashti ka ardhur nga emri i një gruaje e quajtur Rabe apo Rapçe duket se kjo la djem të mbarë që i dallonin me thënie "Si çunat e Rapçes".

Për arsye shëndetësore Maliqi ka disa vite që jeton në Tiranë. Dimri i Velçanit në pleqërinë e thellë po bëhej armiku i tij i fundit. Për të mbajtur gjalle mallin e kujtesën, ai ka ndërtuar hartën skicë të Velçanit të madh me hapësirën e hershme përfshirë Losnik, Jollë, Bishnicë, kufijtë, rrugët, burimet, lagjet i ka përcaktuar me aq merak si të shënonte kufijtë e "Shqipërisë së madhe".

Kur matem ta pyes të mos e pyes nëse shkrim e këndim i mësoj si partizan ai me befason: "Kam mbaruar dy klasë fillore pas vitit 1930, - thotë. Atëherë Velçani ngriti shkollën më të bukur në rrethin e Pogradecit. Unë e ndërpreva se mësonjëtoresh na e dogjën xhandarët e Zogut. Maliqi ishte tepër i ri për të ditur zemërimin e mbretit me



MALIQRAPÇE

velçanakët. Ndoshta nga që këta nuk qenë mësuar t'i nënshtraheshin. Gjithsesi ato dy klasë i vlejten sa dy vite fakultet. Dhe kur dua të di se ç'motive e nxitën të dilte partizan, ai tregon se vdekjen me sy e ka parë përpara sesa të shkonte në luftë. Më shumë se entuziazmi, motivet kanë qenë dëshpëruese. "Në dhjetor të vitit 1943 forcat Gjermane, me dorën e krerëve ballistë i djetëjin shtëpinë bashkë me 11 të tjerë e grabitin mijëra bagëti e duke vrarë dy djem të rinj.

Mua më gjetën teksa kullosja bagëtitë me djalin e xhaxhait - tregon Maliqi. Jo vetëm na rrëmbyen 238 gjë të gjallë, por Haziz Biçaku hipur në kalë urdhëroi të na vrisnin. Për çudi shoqëruesi i tij, një ballist i gjatë me dyfek në krahë varur grykë poshtë, për të na shpëtuar ne gënjen komandantit e tij. "Pse ti vrasim Haziz bej?, e kundërshtoi, - këta nuk janë djemtë e Rapçes janë hyzme-qarë", - kështu shpëtuan. Po unë i ngelur pa shtëpi e pa bagëti, s'mbeti veçse të bashkohesha me batalionin e "Reshit Çollakut" më pas në Brigadën e 20 sulmuese. Jeta dhe ngjarjet e luftës ruajnë të Maliqi shumë të pa thëna, të cilat mund të futësh në histori apo t'i ngresh në këngë e përmendore për një vajze heroinë me emrin Qibrë Sokoli, apo për një trim partizan me emrin Murat Babani që iu vranë përpara syve në luftë me gjermanët një ditë tetori i vitit 1944.

Ai e ka përjetuar dhimbshëm aq edhe trimërisht betejën e zhvilluar nga Qafë-Thana, Përrenjas, Rashtan, Katjel.

Ishte muaji kur ushtria gjermane derdhte gjithë egërsinë e fundit të mbante me çdo çmim vijën strategjike. Dy kompani të brigadës 20 sulmuese, mësynë t'i shkulte prej andej. Forcat balliste tanimë të rrjedhur në numër e në shpresa, nuk dilnin në ballë të luftës. Kështu armiku i betejës në fjalë përbëhej pastër gjak nazisti.

Maliqit iu dha detyra të kapte lartësinë kodër Rashtan. Duke marrë vdekjen në sy, përparonte zjarr me zjarr me gjakun e ndezur në vena. Djaloshi 20 vjeçar sulet të marrë shpagë për luaneshën Qibrë Sokoli dhe trimin Murat Babani. Kur arriti mes shpatit, gjermanët përsë-ritën goditjen me artileri. Një predhë fatale i shpërtheu fare pranë. Mbi trup ndjen breshëri gurësh dhe ashkla predhash, ndërsa këmbën e majtë nuk e komandonte dot.

Një odise e tmerrshme është transportimi i trupit të tij gjithë plagë fashuar veç me shaminë e kuqe të partizanit. Gjaku i rridhte, këmba i varej, dhimbja gjer në kockë është pak të thuhet. Të dyja eshtrat e së njëjtës këmbë i kishte të thyera.

Sot me emocion kujton se për jetën e tij luftonin dy partizan: Ziha Amati që e mbajti në kurriz nga Rashtani në Katjel dhe Xhezar Bego në pararoje. Rrugë kalimet kontrollloheshin prej forcave armike. Prandaj trupi në vig i Maliq Rapçes bëri një hark gjigant udhëtimi nga veri-lindja në jug të krahinës: Katjel, Rodokal, Homezh, Selcë, Homçan, Pleshisht, Çezmë, Shën Marena. Në spitalin partizan të

Shën Marenës mjekët më të mirë ishin infermierët Italianë. Sapo panë këmbën e copëtuar vendosën ta prisnin. Maliqit i dhimbsej këmba, siç i dhimbsej jeta. Si mund të ecte rinia e tij me trupin mbi patericë. Prandaj refuzoi të gjymtohej. Pas pesë ditësh erdhi mjeku me sharrë që nga Lavdari i Korçës, por tanimë sharrimi i këmbës së infektuar për tmerr ishte baras me vdekjen. Maliqi e vuajti gjatë plagën e luftës. Falë përkujdesjes së bashkëluftëtarëve u shtrua nëntë muaj në spitalin e Korçës, më pas dy muaj të tjera në atë të Tiranës. Edhe sot pas 68 viteve çlirim plaga e tij rri e hapur e gjallë. Çuditërisht kjo verë përvëluese e 100 viteve pavarësi, i bëri një surprizë të "bukur" heroike. Qysh prej asaj goditje artilerie në tetor 1944 në shpatullën e djathtë i qëndronte fshehur një ashkël predhe. Maliqi e vuante peshën e kësaj dhimbje duke iu ankuar reumatizms. Tre muaj me parë zbulimin e kreu një grafi e specializuar "Lëre aty ku e ke", i tha mjeku si ta uronte: "Mbaje me shëndet". Tani e djathta, dora e shkopit, ka humbur aftësinë të mbajë filxhanin e kafesë apo lugën e gjellës. Më në fund pas 68 viteve i dorëzon shkopin dorës së majtë.

Megjithatë 89 vjeçari Maliq Rapçe duron, ecën e s'ka ndërmend të dorëzohet. Fatmirësisht bën një jetë familjare të qetë. I martuar me zonjën Nevres Biba kanë sjellë në jetë katër djem për së mbari: Fadili, Seiti, Astriti, Ardiani dhe tre vajza: Florie, Xhavrie, Afërdita. Ndërsa 18 nipërit e mbesat janë dritarja e hapur e lumturisë së tij. Njëri nga nipërit, Rajmond Menkshi, u bë ndërmjetësi për realizimin e këtij shkrimi. Unë zgjodha muajin që mban datën e çlirimtarëve, 29 Nëntor 1944.

Ky është shkurtimisht Maliq Rapçe personazhi i gjallë ndër të paktit. Kur po ndaheshim e pyeta Sa nga 121 bashkëluftëtarët e tij Velçanak kanë mbetur gjallë? Ai natyrisht psherëtiu. 118 u shuan, jetojnë vetëm Dervish Lushka, Serjan Çela, Ali Sosoli secili vuan "fitalat" e luftës çlirimtare e cila përfundoi me triumfin e fitimtarit.

E shikoj teksa largohet e më duket si një pasha, më saktë një kapedan i pa epur që brenda vetes mban dhimbjen e plagëve aq edhe krenarinë e certifikuar në dekoratën e çlirimit dhe trimërisë.

Nëntor, 2012

Redaksia i kërkon të falur autorit, z. Haki Balliu dhe z. Maliq Rapçe për botimin e numrit të kaluar, pasi gabimisht ishte marrë varianti i pakorigjuar.



## HALIL MENKSHI, NJERIU I FJALËS DHE I PUNËS

Nga Nazmi ALLA

Halil Menkshi lindi më 19 maj 1930 në fashatin Homezh Pogradec. Ai rrjedh nga një familje me origjinë fshatare me tradita patriotike. Djaloshin trupgjatë e të imet lufta nazi-fashiste e gjen vetëm 14 vjeç. Ndjenja e lartë atdhetare, urrejtja për pushtuesin e detyron Halilin, megjithëse i vogël në moshë bashkë me kushurinë e vet Qemalin, në pranverën e vitit 1944, me 28 mars t'u bashkohet forcave partizane. Si shumë të rinj e të reja ai rreshtohet në batalionin e rinisë me komandë në Lavdar të krahinës Oparit në Korçë, ku kreu shumë detyra që i ngarkoi komanda deri në qershor të po atij viti. Më pas komanda e cakton me detyrën e korrierit partizan në krahinën e Mokrës në rrethin e Pogradecit, detyrë të cilën e kryen me devotshmëri të plotë. Ndër kohë Ismaili nis partizan edhe djalin tjetër Rakipin, i cili u rreshtua në batalionin e "Reshit Çollakut" ku në përpjekje me gjermanët u plagos në krah dhe dërgohet në spitalin partizan në Skrapar për tu kuar. Detyrën e korrierit partizan Halili e vazhdoi deri në çlirimin e plotë të atdheut më 29 nëntor 1944. Gjatë periudhës së luftës të Halili skaliti guximi, trimëria ndjenja e lartë e përgjegjësisë ndaj detyrës e shumë cilësi të tjera. Pas çlirimit ai tregohet i gatshëm dhe pranon të marrë detyra dhe përgjegjësi të tjera, duke marrë pjesë në aksionet për ndërtimin e vendit, tharjen e kënetës Maliqit, në Cangoj në lumen Devoll, në ndërtimin e hekurudhës Durrës-Tiranë e tjera. Në vitet 1952-1955 thirret për të kryer sherbimin ushtarak në Librazhd, duke e kryer me sukese dhe gëzuar respekt nga komanda dhe shoqëria. Në vitet 1955-1958 zgjidhet në fshat kryetar i këshillit të fshatit dhe kryetar kooperative ne vitet 1969-1971, për tre fshatra me qendër Rodokal i Sipërm. Në vitet 1971-1980 drejton këshillin e bashkuar, duke punuar me popullin, duke qenë i gatshëm në çdo kohë për zgjidhjen e halleve dhe problemeve, me respekt e dashuri me të gjithë popullin. Në vitet 1980-1992 ai punon në minierën e qymyr gurit në Homazh. Nga viti 1993 vazhdon jetën me aktivitete të tjera dhe gëzon pensionin e pleqërisë. Drejton organizatën e veteranve dhe pas ardhësve të tyre, duke u aktivizuar, dhe në mendime dhe veprimtari konkrete në fshat. Me moshën e tij mbi 82 vite jetë ai aktivizohet duke organizuar takime dhe punë konkrete me brezat e rinj për njohjen dhe trashëgiminë e këtyre velerave brezave të ardhshëm.



## Kolina Buzo, solistja e llazoreve

Nga Fahri MUÇO

Në qendër të kësaj fotografie artistike do të dalloni Kolina Buzon sëbashku me Letën, Lisen, Polën, Ciken, Lavdijen etj që përbënin grupin folklorik të fshatit Pevelan. Po cila është Kolina Buzo? Ajo është lindur në fshatin Potkozhan, më 4 dhjetor 1938 nga një familje e madhe dhe e njohur e burnazëve. Babai i saj, Petrika, kishte katër vajza dhe një djalë, Guritin. Kolina u martua në Pevelan me z.Todi Buzo, edhe ky nga një familje e madhe dhe e respektuar. Të shkruash apo të bësh portretin e Kolines, është sa e lehte për nga njohja që patëm (pasi une isha drejtues i Shtëpisë së Kulturës dhe grupit folklorik), aq e vështirë për nga vlerat dhe cilësitë njerëzore të saj. Inteligjenca, humori, shpirtmadhësia dhe sidomos talenti artistik si këngëtare dhe vallëtare, e kanë bërë Kolinën një personazh të nderuar, të respektuar dhe të njohur mes nesh. Pjesëmarrëse e pamunguar e festivaleve folklorike të zonës dhe të rrethit, e pazevendesueshme në rolin e solistes së pare në ritualin magjik të llazoreve, këtij rituali brilant të ndaluar prej tri dekadash nga ideologjia e sistemit të diktaturës. Me ardhjen e demokracisë, si çdo vlerë e muar, edhe llazoret panë dritën e lirisë së tyre. Por tani vajzat e reja nuk i dinin këngët e ritualit, ndaj iu turrën Kolinës, vetëm ajo mund t'i ketë mbajtur mend,

thoshin nuset e fshatit. Dhe ashtu ndodhi, në shtëpinë e saj shtruar me qilimat me thekë lloj-lloj ngjyrash të bërë në vegjë me duart e saj të arta, u mblodhëm për disa ditë rresht dhe ringjallëm ritualin e famshëm të llazoreve, te cilat u pasuan nga çupat e fshatit që filluan shëtitjet derë më derë nëpër fshat, por edhe në fshatrat e tjerë përreth, pa dallim feje dhe besimi, duke bërë të buçasin odat e fshatit prej këngeve dhe tratatruket e këpucëve të zeza me gjysmë take, të gjitha njëllor. Lum kush i ka shijuar ato çaste ngazellyese! Por ky ritual përbente një vlerë të rrallë për folklorin e zonës së Mokres dhe atë të rrethit, pasi ai shoqërohej edhe nga kostumet karakteristike popullore, disa prej të cilave i kishin ruajtur për vite të tëra nëpër sëndyqe dhe i nxorën plot mall tani. Ritualin e llazoreve tërhoqi vëmendjen e Institutit të Folklorit në Tiranë, saqë në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës u nderua me diplomën e festivalit, kurse etnografia e shquar Andromaqi Gjergji mbrojti doktoraturën në Europë me këtë ritual. Nga interpretimet më të bukura dhe të arrira, Kolina kishte baladën e Ymer Agës, si edhe këngën e luajtur humoristike: "Bëri halloja dasmë".

*"Moj hallo, moj kokëthatë,  
Bëre dasmë me një patë  
Hëngrën burrat, ngelën gratë  
Jo, muk dua verë shumë,  
Po një vozë vetëm unë,  
Jo nuk duam bukë shumë  
Po një furrë vetëm unë."*



*Jo, moj jo, se bëjmë shaka,  
Se dasma kështu e ka  
Këndojmë këngë e hedhim valle  
Të buçasin këto male!*

Po cilat ishin pengjet e Kolinës? Së pari pengju i saj ishte mungesa e një fëmije, ç'ka i mohoi fatin për të qenë nënë, e megjithatë, ajo asnjëherë nuk e tregoi trishtimin e saj. Pengju i dytë ishte se ajo asnjëherë nuk shkoi në Festivalin Kombëtar të Gjirokastrës, pasi vinte nga një familje e padëshiruar për ideologjinë e kohës, babai i saj, Petrika Burnazi, ishte damkosur si kulak!! Gjithë kohën ka punuar në kooperative duke bërë punë të rënda, si të gjitha gratë e tjera (gratë mbanin peshën më të madhe në kooperativat bujqësore!!!). "Shyqyr që kemi Kolinën në brigadë, se një fjalë të flasi ajo, shkrihem si qeshuri,

e harrojme lodhjen fare", - thotë dhe kujton me shumë respekt Mukadezi, bashkëmoshatarja e saj. Por Kolina u nda shumë shpejt nga jeta, ndaj tani që nuk e kemi më, para sysh na del portreti i gjallë i saj me ato shtizat nëpër duar e që thur triko duke ecur, a thua se thurte kështu edhe ëndrrat e saj për jetën, disa prej të cilave i mori me vete. Kolina shkoi dhimbshëm jo vetëm për moshën e parakoheshme, por edhe për faktin se la të vetëm bashkëshortin e saj, Todin, i cili ndjen jo pak mungesën e saj, edhe pse ai ka perkrahjen e vëllezërve, motrave, nipërve dhe mbesave të tij, që i ndodhen gjithnjë pranë. I mbyllem këto radhë si një nderim dhe kujtim për Kolina Buzon, njeriun, gruan dhe artisten që nuk ka për t'u harruar, për gjurmët e mira që i la kësaj bote.

# Në rrugën e artit

Nga Tomi MATO

Lori Lako, një vajzë e vogël e cila ëndërron te që një ditë të ndiqte rrugën e babait të saj, piktorit të mirënjohur Gjergji Lako. Kështu nisi rrugën e artit në liceun "Tefta Tashko Koço", në qytetin e Korçës. Vitet rrjedhin e Lori vazhdon me seriozitet rrugëtimin në art në bangat e shkollës së mesme, duke u aktivizuar në aktivitete lokale dhe kombëtare. Vlerësohet me çmimin e dytë në konkursin "Larg dhunës". Më pas ndjek workshop-in "Komunikim përtej kufijve", sëbashku me një grup të rinjsh nga shtete të ndryshme të Ballkanit në qytetin e Ohrit, Maqedoni. Aktiviteti finalizohet me një ekspozitë të përbashkët. Në vitin 2008 merr çmimin e parë në ekspozitën me rastin e mbylljes së vitit shkollor. Po këtë vit vlerësohet me çmimin e parë në konkursin e organizuar nga Agrinas II Master of Art exhibition". Në vitin 2009 përmbyll studimet e shkollës së mesme dhe nisjet drejt një ëndrre. Konkurren në Akademinë e Arteve të Bukura të Firences, në Itali. Pranohet dhe regjistrohet në degën Pikturë - Vizatim. Italia me artin e saj dhe sidomos Firence, djepi i Rilindjes, kishin qenë vendimtare për këtë zgjedhje aspak të lehtë e shumë të rëndësishme. Gjatë tre viteve të studimit merr pjesë në Estemporanea e përvitshme e pikturës në San Piero a Sieve, gjithashtu në ekspozitën "Arti në Montecalvo". Me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë merr pjesë në ekspozitën e përbashkët të artistëve shqiptarë që jetojnë në Itali në Muzeun e Qyte-tërimit Roman, Rome. Organizon së



bashku me studentët shqiptarë të Akademisë ku ajo studion "Serata d'arte" - "Mbrëmje arti". Pozicionohet në vendin e dytë në aktivitetin e përmuajshëm të artit në Akademi. Diplomohet në shtator të 2012 nën drejtimin e profesor Umberto Bisit e Sandro Bellesi-t me tezen "Takim me ekspresionizmin" me maksimumin e vlerësimit. Pas përfundimit të studimeve 3-vjeçare pranohet në specializimin 2-vjeçar, po në këtë Akademi, në degën Pikturë dhe, gjuhësi të reja shprehëse, ku aktualisht ndjek vitin e parë. Pikturës tashmë i shtohen mjete të reja dhe bashkëkohore. Pasioni zgjerohet me mundësitë që ofron koha.

Shkak për këtë shkrim bëhet ekspozita e Lorit në qytetin e lindjes, Pogradec, në vigjillje të Krishtlindjeve. Ekspozita përfshin rreth 150 punime të realizuara gjatë periudhës së shkollës së mesme në teknikat: laps, penë, pastel, akuael e bojëra vaji. Ekspozita tregon hapat e para të artistes së re. "Çdo ndjenjë, ide, reagim apo mendim përfaqëson një ngjyrë, një linjë, një njollë, një imazh të përjetësuar në celuloid. Shpirti i saj shkon në mënyrë të pandërgjegjshme drejt ngjyrës, mjetit, materializimit që ndjenja zgjedh për të veshur momentin e jetuar, perceptuar apo të panjohur... Në mënyrë të tillë bëhet e pamundur të gënjeshtrohet përpara



## Pogradec: Ekspozitë pikturë nga Lori Lako

Qendra kulturore "Lasgush Poradeci" ka çelur mbrëmë në galerinë e arteve, në prani të njaft artdashësve, ekspozitën personale të piktores së re Lori Lako, me 150 punime nga periudha e krijimtarisë së saj artistike. Vepra e saj, siç vuri në dukje piktori K. Durollari, ndonëse e përkufizuar te vizatimi, (portret, natyrë e qetë, grafika, pastel, akuarel), tregon se piktorja shpreh ambicien për të zënë një vend të merituar në pikturë. Lori Lako është lindur në Pogradec në vitin 1991.

një telajoje të bardhë, flete vizatimi apo filmi fotografik bosh. Akti i krijimit është akt sinqeriteti në raport me vetveten dhe spektatorin"

Kjo është arsyeja përse ajo të zgjedh të shprehet nëpërmjet artit viziv: thotë piktorja e talentuar Lori Lako. Ekspozita e saj ngjalli kuriozitet jo vetëm në artdashësit pogradecarë, veçanërisht në moshataret e saj dhe nxënësit që ndjenë kënaqësinë shpirtërore, kur u përball me punimet e saj të bukura. Ato, veçanërisht portretet e punuara me finesë e saktësi dhe tipëzonin karakterë e mbi 20 portreteve. Kur gjendeshin përpara tyre të ngjallnin emocione dhe detyronin të dialogojë me to. Punimet e saj jo vetëm të ngjallnin respekt për krijimet e Lorit por të krijonin respekt se ajo ka perspektivë të ndjekë dhe nderojë babain e saj, piktorin e njohur të qytetit tonë Gjergji Lakon. Ajo bindi bashkëqytetarët ese plejadës të nderuar të piktorëve pogradecarë si Anastas Kostandinit

"Artist i merituar", Gjergji Lakos, Vangjo Vasilit, Gentian Zekës, etj do ti shtohet edhe një talente që i ka perspektivën të ngrejë akoma më lart nderin e "Arteve figurative" në qytetin e Pogradecit. Shfletova "Bilokun e përshlytyjeve" ku dhjetëra qytetarë janë mbresat e tyre për emocionet e gëzueshme që ndjejnë nga ekspozita figurative e piktores të ardhshme Lori Lakos. Gati gjithë vizitorët bashkoheshin në një emërues të përbashkët në fund të mbresave të tyre, jo për kompliment por me një urim që i buronte nga zemra buronte shprehja: "TALENTI ËSHTË DHURATË - SUKSESI ËSHTË PUNË". Me gjithë shpirt i uroj autores të kësaj ekspozite sukses të mëtejshme duke punuar akoma më shumë që të nderojë familjen, qytetin e lindjes dhe verë një buqetë me lule në lavdinë e arteve figurative Pogradecare dhe kombëtare. Presim ekspozita të tjera, akoma më të bukura nga piktorja e talentuar Lori Lako.